V E N D I M
Nr. 325, datë 23.6.2000

PËR KRIJIMN E QENDRËS KOMBËTARE "PËR MIRËRRITJEN, ZHVILLIMIN DHE REHABILITIMIN E FËMIJËVE", SI NJËSI BUXHETORE, E VEÇANTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29,të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 13, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2000", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shkëputjen e Qendrës Kombëtare "Për mirërritjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e fëmijëve", nga Drejtoria e Shëndetit Publik, Tiranë, qytet dhe përcaktimin e saj si njësi buxhetore kombëtare të veçantë, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.
2. Drejtorisë së Shëndetit Publik, Tiranë, qytet, i pakësohen në numrin e punonjësve 67 punonjës, të cilët i shtohen Qendrës Kombëtare "Për mirërritjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e fëmijëve".
3. Efektet financiare, që lindin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2000, për Ministrinë e Shëndetësisë.
4. Ngarkohen Ministria e Financave, që, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, të ndjekë procedurat e nevojshme për kalimin e fondeve buxhetore dhe për krijimin e strukturës së re buxhetore për këtë qendër.
5. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta